

Seminari- Politikat për Promovimin e Industrisë

23 shkurt 2012

JICA Alumni Asociacioni i Kosovës- JAAK , Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia-Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar –JICA, me mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor organizoi këtë seminar.

Qëllimi i këtij seminari ka qenë përcjellja e përvojave të marrura në Japoni, në lidhje me Politikat e Promovimit të Industrisë.

Prezantimet u bënë nga z. Bujar Istogu dhe z. Zef Dedaj, zyrtarë të MTI-së si dhe pjesëmarrës në trajnim në Japoni.

Ata prezantuan mbi standardizimin, si një formë e vetë-rregullimit, ku palët e interesuara, së bashku, vullnetarisht, janë pajtuar për çështjet (zakonisht teknike), të cilat i lejojnë ata për të konkurruar në treg, në mënyrë më efektive dhe për ligjin themelor për Ndërmarrjet e Vogla dhe të

Mesme. E tërë kjo punë është kryer nga ekspertët që punojnë direkt në sektorët industrial dhe të



biznesit, të cilët kanë identifikuar nevojën për standarde, dhe më pas ata i kanë përcaktuar standarde të cilat do të i përdorin në zhvillimin e biznesit të tyre.



Pas diskutimeve të shumta u nxorrën edhe konkluzat:

- ◆ Zbatimi i bashkëpunimit midis qeverisë, të industrisë dhe akademisë
- ◆ Promovimi i vayhdushëm i industrisë (NVM)
- ◆ Mungesa e fondeve

Seminar: Parandalimi i sëmundjeve profesionale dhe mbrojtja e mjedisit të punës

Date: 27 shkurt 2012

Me mbështetjen e JICA dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale JAAK organizoi këtë seminar. Prezantimi në lidhje më temën e lartëcekur, u bë nga z. Gezim Xërxa, inspektor i punës/ MPMS dhe ish pjesëmarrës trjnimin e JICA.



Qëllimi i këtij seminari ishte prezantimi i përvojës së fituar në trajnim, ku u prezantua sistemi i menagjimit të mbrojtjes së shëndetit të punëtorit dhe mjedisit ku punon ai.

Në pjesën e parë Z.Xërxa prezantoi programin e ndjekur gjatë trajnimit (përvoja japoneze) dhe në pjesën e dytë, u prezantua Plani i Veprimit i cili ishte përgatitur prej tij, përkatësisht aktivitetet e paraqitura për parandalimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e kushteve të punës. Pas prezantimit të pranishmit diskutuan mbi mundësitë e shftrtëyimit të këtyre përvojave në Kosovë.

Konkluzat:

- Kompletimi i legjislacionit
- Mungesa e pajisjeve për matje në mjedisin e punës
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore



JAAK
JICA Alumni Association of Kosova

Së bashku me JICA

**Inaugurimi i monumentit
Miqësia mes
Republikës së Kosovës dhe
Japonisë
"RRUGA E ZHVILLIMI"**




2012

Nr. 7



**Bashkëpunimi
Republika e
Kosovë Japoni**



Inaugurimi i monumentit

Miqësia mes

**Republikës së Kosovës dhe Japonisë
"RRUGA E ZHVILLIMI"**



Në shenjë miqësie në mes Republikës së Kosovës dhe Japonisë, në Prizren, u vendos një skulpturë që u quajt- Rruga e Zhvillimit. Kuvendi i kësaj Komune ka falënderuar Qeverinë japoneze për ndihmën e dhënë në fushën e mbrojtjes së Mjedisit.

Shefi i Zyres së JIC-as për Ballkan Z. Sato Kurusava, ka thënë se mbështetja me projekte që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, do të vazhdojnë edhe në qytetet tjera të Kosovës, gjithnjë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Zëvendësministri i MMPH-së, Z. Shpëtim Rudi ka theksuar se kjo Skulpturë simbolike e cila quhet "Rruga e Zhvillimit", ka domethënie të madhe, sepse simbolizon miqësinë e Kosovës me Japoninë.

Seminari Zëvendësimi i pajisjeve të ndriçimit: vështrimi në teknologjitë ekzistuese

Date: 30 janar, 2012

JAAK me mbështetjen e JICA dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), në lokalet e TC Kosova B, u zhvillua seminari mbi "Ndërrimi i pajisjeve të ndriçimit, vështrimi në teknologjitë ekzistuese, sfidat dhe ndikimin në mjedis".



Z. Lutfi Bina, koordinator për efikasitetin e energjisë dhe kontrollit dhe pjesëmarrës në trajnimin e JICA-s mbi "Ruajtjen e Energjisë dhe Teknologjitë, Teknikave për diagnostifikim, prezantoi për përvojat e fituara në Japoni në lidhje me këtë temë.

Nga diskutimit e bëra, dolën edhe konkluzat;

⇒ Përdorimi i llampave efikase të energjisë dhe pajisjeve në KEK - nevojat dhe mundësitë, për të kursyer energji përmirësimi i ndriçimit, duke përdorur llampa që kursejnë energjinë

⇒ Finalizimi i legjislacionit,

⇒ Mungesa e burimeve financiare Përfitimet mjedisore dhe të tjera

Mbështetja nga JICA

Projekti për rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave i cili po zhvillohet në komunën e Prizrenit dhe Prishtinës është duke u zhvilluar me sukses.

Nga JICA në Japoni z. Satoshi Iëakiri, CEO, znj Mizuki Kitaoka, Europe Division, dhe znj Yumi Yasuda JICA, JICA Ekspert / Këshilltar ODA, vizituan Kosovën dhe zhvilluan takime në komunën e Prizrenit, Prishtinës dhe MMPH.

Z. Iëakiri, theksoi se zbatimi i projektit për rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave në aspektin material, në Komunën e Prizrenit është shumë i qëndrueshëm, i dobishme dhe i frytshëm. Edhe pse situata aktuale në Japoni është mjaft e rëndë,

